

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Ramë Hyseni dhe Fejzullah Rexhepi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L. K. nga Prishtina, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK sh.a, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuari H.I. punëtor i së njëjtës, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1031/12 i datës 16.09.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.09.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. VERTETOHET pika I (një) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1031/12 i të datës 16.09.2014, në pjesën me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditëses L. K. nga Prishtina dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK sh.a, me seli në Prishtinë, Nr.01-1040-949/12 i datës 07.03.2012, me çka ankesa e të paditurës lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadiës REFUZOHET si e pabazuar.

II. Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK sh.a, me seli në Prishtinë, PRISHET pika I (një) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1031/12 i datës 16.09.2014, në pjesën e kërkesëpadiës me të cilën është detyruar e paditura që paditësit ti paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe të trustit në mes të gradës 9 dhe 8, për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012, me kamatë 4% deri në pagesën definitive si dhe pika II (dy) e dispozitivit të te njëjtit aktgjykim që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, dhe lënda në këtë pjesë i kthehet në rishqyrtim dhe vendosje gjykatës së shkallës së parë.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C-nr. 1031/12 i datës 16.09.2014, me pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses L. K. nga Prishtina, e ka anuluar aktvendimin e të paditurës Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, Nr.01-1040 949/12 i datës 07.03.2012, dhe e ka detyruar të paditurën që paditëses ti paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 9 dhe 8, për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012, e tutje me kamatë 4% e deri në pagesën definitive. Ndërsa me pikën II (dy) të dispozitivit ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale. Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit

të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës ndërsa padia e paditësit të hedhet e pas afatshme, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet kërkesëpadia apo të prishet aktgjykimi i ankimuar dhe të kthehet lënda në rishqyrtim dhe vendosje tek gjykata e shkallës së parë.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e ushtruar nga e paditura.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditëses kundër të paditurës, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka marrë aktgjykimin e atakuar. Në procedurën e të provuarit ka administruar prova dhe ka vërtetuar gjendjen faktike sipas të cilës është vërtetuar se paditësja në cilësinë e punëmarrëses dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratën Nr.01-2880-2588/2011, e datës 20.10.2011. Sipas kontratës së punës paditësja pranë të paditurës përcaktohet në kryerjen e detyrave të punës zyrtare e burimeve njerëzore, në njësinë-Telekomi i Kosovës. Sipas nenit 5 të kontratës është përcaktuar se të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 9. E paditura me vendimin e burimeve njerëzore Nr.01-1040 949/12, i datës 07.03.2012, paditëses i cakton të ardhurat personale mujore në lartësi të gradës 8, sipas strukturës së gradave duke i ulë paditëses gradën nga 9 në 8. Sipas këtij vendimi lartësia e të ardhurave personale implementohet nga data 01.02.2012, e i cili vendim sipas të paditurës konsiderohet si pjesë përbërëse e kontratës së punës Nr. 01-2880-2588/2011, të datës 20.10.2011. Ky vendim i të paditurës ka ardhur pas shkresës të datës 06.12.2011, të Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, drejtuar kryetarit të bordit të drejtorëve të paditurës, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të t'paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%. Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë e aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Ka arsyetuar se kontrata e punës është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht me dispozita e nenit 11 ku përveç tjerave përcaktohet se kontrata e punës duhet të përmbaj lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër, e me qenë se paditësja dhe e paditura me kontratë të punës janë pajtuar për lartësinë e pagës mujore të paditëses me gradë 9, gjykata gjeti së kërkesëpadia është e themeltë.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të arsyesimit të aktgjykimit të ankimuar, ka vlerësuar se kontrata e punës e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës është

marrëdhënie kontraktore e cila është krijuar duke i respektuar kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës dhe atë aftësinë punuese të palëve kontraktuese, vullnetin e palëve, lëndën e kontratës dhe bazën e kontratës. Lidhur me këtë sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të shprehur mund të krijojnë raportin juridik, prandaj kontrata e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës mund të ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të dy palëve kontraktuese, andaj nuk mund të ndryshohen kushtet e kontratës së punës vetëm me shprehjen e njëanshme të vullnetit të njërës palë, e lidhur me këtë gjykata e shkallës së parë ka gjetur se vendimi i atakuar i të paditurës është i kundërligjshëm dhe në asnjë mënyrë nuk mund të pranohet si pjesë e kontratës përderisa të dy palët nuk pajtohen për ndryshimin e kushteve të kontratës.

Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë e ka mbështetur në dispozitën e nenit 11, 55 dhe 87 të Ligjit të Punës, për kamatën ka vendosur konform nenit 186 dhe 277 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore ka vendosur konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e parë të dispozitivit me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditëses dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës, Nr.01-1040-949/12 i datës 07.03.2012, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar në këtë pjesë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit çdoherë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike për këtë pjesë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga Gjykata e shkallës së parë e cila edhe ka dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat kanë mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në bazë të kontratës së punës e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës, paga është përcaktuar sipas gradës 9 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të t'paditurës, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të t'paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditëses pasi që në rekomandimin e Ministrisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajizuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues. Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale ngase përveç dispozitave të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykim edhe dispozita e nenit 55 paragrafi 1, të Ligjit të Punës përcakton së: *“ I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila*

*përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”.*

Në këtë rast punëdhënësi dhe punëmarrësi me kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar përveç tjerave edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, ngase sipas të paditurës dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë.

Sipas Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është mjaft i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe të arsytimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore.

Gjykata e vlerësoi të pabazuar pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me afatshmërinë e padisë për shkak se, në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, “Ligji nr. 03/L-212 të datës 01.11.2010” saktësisht parashihet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3- vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës dhe duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, kjo gjykatë vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar të drejtën materiale. Po ashtu edhe në bazë të nenit 372 të LMD, i cili ishte në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë, saktësisht është përcaktuar se kërkesat periodike parashkruhen 3-vjet, nga rrjedha e secilës dhënie të veçantë për pagesë andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të këtyre ligjeve rrjedh se drejtë është aplikuar e drejta materiale nga ana e gjykatës të shkallës së parë, e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike.

Aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën që është prishë dhe është kthyer në rishqyrtim sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë në dispozitiv e rrjedhimisht dispozitivi është në kundërshtim me arsyet e dhëna. Dispozitivi është i paqartë sepse nuk është përcaktuar lartësia e ndryshimit të pagës, ndryshimit të bonusit dhe trustit në mes të gradës 9 dhe 8, e cila duhet të paguhet nga e paditura, ndërsa është në kundërthënie me arsyet e aktgjykimit sepse kjo pjesë e kërkesëpadisë nuk është arsyetuar përkatësisht nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që gjykata të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Për pjesën e kthyer në rigjykim, gjykata e shkallës e parë udhëzohet që në ri procedurë të vërtetojë se a është kontestuese në mes të palëve ndërgjyqësore lartësia e kërkesëpadisë dhe varësisht nga deklarimi i palëve për kontestueshmërinë e lartësisë së kërkesëpadisë, sipas nevojës përmes nxjerrjes se provës më ekspertizë përkatëse ta vërtetoj lartësinë e kërkesëpadisë, ashtu që pas administrimit dhe vlerësimit edhe të provave tjera nga shkresat e lëndës të vendos në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Në lidhje me vendimin për shpenzimet gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi sepse shpenzimet duhet të përcaktohen në mënyrë unike për të gjitha shpenzimet e pranueshme në përfundim të vendosjes meritore për të gjitha kërkesat.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (c) dhe pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 4885/2014, me datë 30.09.2016.

Kryetari i kolegjit  
Qerim Ademaj, d.v